



'Dinjiteti Njerëzor dhe Respekti i Ndërsjellë'

Description

Abdal Hakim Murad

Forumi i Parë Katoliko-Musliman, Romë, 5 Nëntor 2008

Shkëlqesia Juaj, miq dhe të ftuar të nderuar!

Paqja, mëshira dhe bekimet e Zotit qofshin me ju!

Takimi ynë në këtë vend historik është, dashtë Zoti, një kremtim dhe shenjë shprese. Një kremtim sakohë ne së bashku kremtojmë me fjalët e shpallura të Zotit, të frymëzuar dhe të vendosur për të përcjellë në komunitetet që përfaqësojmë mesazhin e të vërtetës dhe pajtimit. Dhe shpresë, të bindur se mbikqyrja e Zotit mbi kuvendin dhe zemrat tona gjatë këtyre ditëve do të na bëjë të shohim të metat tona, dhe shenja me të cilën shkëmbimet më të mira dhe më të frytshme të dy feve tona në të shkuarën do të mbesë frymëzuese për ne, ndërsa gjejmë udhë të reja dhe të suksesshme për të kapërcyer si keqkuptimet ashtu edhe gabimet e qëllimshme, që në të kaluarën na kanë çuar në konflikte të urryera prej Zotit.

Është e qartë për të gjithë ne se sa e ngushtë është lidhja ndërmjet temës së madhe të diskutimeve të djeshme dhe temës që po trajtojmë sot. Me të vërtetë, është kjo lidhje që qëndron në zemër të asaj troshitjeje të përgjigjes religjioze karshi krizës së modernitetit. Në epokën tonë po bëhen përpjekje madhështore për të vlerësuar njerëzimin përmes kodesh të të drejtave të njeriut dhe konventash ndërkombëtare të shumëllojshme. Sot, filozofia, e cila në klimën e soçme të mbizotëruar nga shekullarizmi kërkon të ofrojë themelet e këtyre përpjekjeve, duket se përjeton një gjendje krize. Iluminizmi, burim i një pjese të mirë të asaj çka është e vyer në kuptimin bashkohor mbi dinjitetin njerëzor, u sulmua në kohën e tij nga mendimtarë fetarë dhe nga disa mendimtarë shekullarë të cilët dyshonin në pretendimet e një etike të pastër shekullare dhe një domosdoje kategorike rrënjëzuar në një shpresim të pakufishëm, në zotësinë morale të një arsyeje dhe shkence të pandihur. Ky pesimizëm pjesërisht është vërtetuar si i arsyeshëm. Europa, djepi i Iluminizmit, është sot shtrati i një relativizmi postmodern i një lloji mjaft të helmët. Shpirtrat e çliruar nga kutia e Pandorës e *Lumières* dhe *Aufklärung*, dhe në vendin tim nga Loku dhe Hjumi janë provuar në disa raste si aleatë të engjëjve,

por në raste të tjera kryekëput bij të mbretërive skëterrore të shkatërrimit dhe armiqësisimit. Europa – dhe unë këtu flas si european – është në krizë; besimtarët, të cilët prej kaq kohësh, herë me të drejtë e herë nga frika i bënë karshillëk projektit të Iluminizmit, sot janë thërritur të shërojnë dhimbjet e tij të forta. Të krishterët dhe muslimanët, si ndjekës të dy feve më të mëdha të Europës, duhet të punojnë bashkë pa mëdyshje, si kurrë më parë për të gjetur një shërim. Gjithëpoaq, ne duhet të punojmë për të garantuar që sëmundja e zemrës Europiane, e shprehur sot në një shpërfillje të pashoqe ndaj fesë, të mos përhapet në të gjithë botën.

Në fakt, këtu dua ta drejtoj gishtin. Si një qytetar dhe mbrojtës i Bashkimit European, unë e shoh veten pjesë të një shoqërie tragjikisht të papërzotshme. Së fundmi një sociolog botoi një libër nën titullin *Vdekja e Britanisë së Krishterë* dhe kjo më lëndon thellë sepse ajo që po vdes është në fakt ngrehina e bindjeve të njëzotshme dhe e një jete me lutje e ndihmë të ndërkahshme njerëzore, që si muslimanë ne duam ta shohim duke lulëzuar rreth nesh. Unë jam sakaq edhe një besimtar musliman. Kjo ndërthurje e Europianes dhe Islamikes do të ishte më pak e vështirë nëse Europa do të ishte më besnike ndaj përmasës së krishterë të trashëgimisë së saj. Unë parapëlqej të jetoj në një shoqëri të krishterë përkarshi një shoqërie shekullare.

Kjo ndjesi humbjeje i jep gjunjë angazhimit tim të përveçëm në procesin e Fjalës së Përbashkët. Ashtu siç e dini, takimi i këtij Forumi këtu në Romë është rrjedhojë e nismës së lëshuar një vit më parë nga dijetarët muslimanë të cilët, të shqetësuar për gjendjen aktuale në botë, zgjatën dorën përkrahjes dhe vullnetit të mirë drejt krerëve të Krishtërit. Arsyeja që personalisht firmosa, përveç konsensusit të firmëtarëve të dokumentit se bota ka nevojë për një shërim dhe që muslimanët janë porositur të grishin njerëzimin tek parimet e pavdekshme të dashurisë për Zotin dhe fqinj, që brengosja ime e veçantë për boshatisjen e Europës nga feja dhe për zbehjen e dinjitetit njerëzor dhe gëzimit që vjen si rezultat i tyre.

Nëse në shumë rajone brendaqytetëse, dhe gjithnjë e më shumë gjetkë, muslimanët jetojnë si një pjesë e rëndësishme e Europës, atëherë ka një sferë të gjerë për punë të përbashkët kundër këndvështrimit aktual të kontinentit mbi të ardhmen dhe vizionin njerëzor. Është besimi im që ngulmimi aktual i Selisë së Shenjtë për të ringjallur trashëgiminë fetare është kryekrej i drejtë. Është me rëndësi të sjellim ndërmend se Kisha Katolike, si institucioni më i vjetër në botë, ka një kujtesë të gjatë që ngërthen situata të tjera të mëhershme kur e ardhmja dukej e errët. Shën Benedikti i Nursias, pesëmbëdhjetë shekuj më parë, jetoi gjatë pushtimeve Barbare, të cilët kërcënonin Europën me një relativizëm politeist dhe me një etikë çnjerëzore babëzie dhe mbizotërimi. Shërimi, ashtu siç e gjykoi edhe Benedikti ndërsa jetonte aktualitetin e jetës së tij, që fuqia e pafund e sigurisë së shpallur e mbrojtur dhe e përforcuar nga arsyeja.

Me udhëheqjen aktuale, Selia e Shenjtë është në pozitën e duhur për të vërtetuar pretendimet e saj si një mbështetëse e arsyes së vërtetë. Kjo e vendos atë, ashtu siç muslimanët e shohin çështjen, në një pozitë ideale për bashkëveprim me muslimanët dhe sigurisht me të tjerët, në përbushjen e detyrës së rrëzimit të pesimizmit dhe sundimit të opinionin arbitrar.

Teologjia islame, ne tashmë e dimë, trashëgoi disa nga metodat dhe kategoritë e saj të hershme nga të krishterë si Gjon Filoponusi, të cilin ne e njohim si Jahja en-Nahvi. Njëherazi, në rrethanat kyçe të historisë së saj, Europa e krishterë është përforcuar nga mësimet e mendimtarëve muslimanë. Kush mund ta hedhë poshtë ndikimin e Ibn Rushdit, gjykatësin e Sheriatit të Kordobës në kohën e Shën Thoma Akuinit? Apo peshën e Gazaliut, i njohur mes latinëve si Algazel, në hedhjen poshtë të

metafizikës së keqvendosur dhe shpeshherë nënpagane të Avicenës? Apo *mutekel'limun*-ët, teologët muslimanë të njohur si Eloquentët në Perëndim, rreptësia e të cilëve në përdorimin e arsyes i bëri ata bashkëbisedues idealë, përkundër distancës së kërkuar nga kultura e kohës për mendimtarët e krishterë më rigorozë? Ndërsa Europa sot përballet me barbarët e rinj, të cilët janë postmodernistët dhe relativistë të tjerë që, jo nga jashtë, janë produkt i një evolucioni të vetë jetës së saj të brendshme, një konvergjencë e tillë mund të shërbejë si një pasuri jetike. Respekti ynë i ndërsjellë mund të mbështetet mbi praktikën e përbashkët me sëmundjen e Europës.

Nevoja për ta mbështetur dialogun tonë mbi idetë tejtheksohet nga obligimi i misionit, kaq i spikatur në të dy traditat. Një bashkëveprim i thjeshtëzuar mbi praktikën do të rrezikonte të mbyste bisedimin teologjik, që është sigurisht më afër thelbit të ndonjë krahasimi të vërtetë të tezave religjioze.

Nga mesi i studiuesve evropianë të Islamit në shekullin e kaluar, shumë prej më të mëdhenjve ishin besimtarë katolikë të cilët, duke ndjekur gjurmët e Maritain-it apo interesimit neo-Tomist mbi filozofinë arabe, dhanë kontribute rrënjësore në kuptimin tonë të teologjisë muslimane. Mes tyre ne duhet të përmendim dijetarët e mëdhenj domenikanë Georges Anawati dhe Luiz Gardet, manuali i të cilëve i vitit 1948 për teologjinë islamike dëshmon rëndësinë e arsyes në kulturën islamike dhe vlerën e krahasimeve të hollësishme me Tomizmin. Fokusi i tyre islamik ishte Hanbelizmi dhe Esh'arizmi. Por maturidizmi, shkolla e tretë sunite e teologjisë, u shndërrua në interesimin e veçantë të Jozef Van Ess të Universitetit të Tübingenit. Van Ess na risjell insistimin e Maturidinjeve, të pranishëm edhe te Gazaliu dhe shkolla e tij, në racionalitetin e Zotit. Në historinë e tij madhështore prej katër vëllimesh mbi teologjinë e hershme muslimane, Van Ess nënvizon ngulmimin e vazhdueshëm të Islamit në rrënjët hyjnore të arsyes. Ai madje shkruan:

Krishtërimi flet për "misteret" e fesë; Islami nuk ka asgjë të ngjashme. Për Shën Palin, arsyeja i përket mbretërisë së "mishit", për muslimanët, arsyeja, 'akl', është kryeafërsia që i është falur qenieve njerëzore nga Zoti. [1]

Van Ess dhe dijetarë katolikë të hershëm i kanë bërë botës një shërbim të pallogaritshëm. Aktivistët shekullarë të një brezi më parë pëlqenin ta shihnin Islamin si një adhurim të Zotit të mosarsyes, një despotizëm legalist larg prej shqetësimit apo ngjasimit njerëzor. Shpesh, Islami përngjasehej me Judaizmin, të cilin një Orientalizëm më i vjetër zgjodhi ta vështronte njësoj 'semitik' në kundërshtimin e arsyes helenike apo të ndonjë lloji tjetër. Këtu, për shembull, është Ernest Rénan, kryeracionalisti, që shkruan në 1862:

Në kohën tonë, parakushti thelbësor për të përhapur qytetërimin evropian është shkatërrimi i çdo gjëje semite *par excellence* ... shkatërrimi i Islamit ... Islami është mohimi më i plotë i Europës: Islami është fanatizëm ... Prandaj e ardhmja, zotërinj, i përket Europës dhe vetëm Europës ... Kjo është lufta e përjetshme, luftë që do të marrë fund vetëm kur biri i fundit i Ismaelit (Ismailit) të vdesë në mjerim, apo të jetë syrgjynosur me terror në skutat e shkretëtirës.[2]

Rénan, hero i *lumières*, është i bindur se Islami dhe Judaizmi nuk kanë asgjë për të thënë për idenë e dinjitetit njerëzor. Ne do të shtonim se kuptimi i tij mbi Krishtërimin klasik është, pa dyshim, fort më zemërdhembshur.

Me bekimin e Zotit ne kemi shkuar mjaft përpara dhe muslimanët duhet t'i falenderojnë dijetarët katolikë për braktisjen e kategorizimeve të vjetra dhe efektivisht anti-semite në përkrahje të një kuptimi të Islamit si një fe në të cilën besimi me arsye dhe një Zot i arsyeshëm janë qendrore për një teologji

serioze.

Studiues të tillë katolikë na kanë dhënë një imazh të Islamit që vendtakohet në çështje kyçe me kuptimin katolik modern të dinjitetit të përhershëm të qenieve njerëzore. Shejkh El-Buti i është mbështetur shpeshherë shumë treguesve Kuranorë të këtij parimi. 'Ne i kemi fisnikëruar bijtë e Ademit' – thotë Kurani (17:70). Ademi është krijesa e vetme, të cilit Zoti urdhëroi t'i përmbysen me ballë në tokë (7:11). Kjo i kushtohet faktit se Zoti ka krijuar në njeriun një shpirt që është prej Tij Vetë (15:29; 32:9; 38:72). Për këtë arsye dijetarët tanë, dhe veçanërisht maturidijtë dhe hanefijtë, këmbëngulin se të drejtat janë të lindura në qeniet njerëzore, më shumë se sa të fituara më vonë në një mënyrë që do t'i bënte ato tërësisht subjekt të zgjedhjes religjioze. Do të doja të citoja, lidhur me këtë, fjalët e Imam Sarakhsi, juristit hanefi që vdiq në 1090:

Që në krijimin e qenieve njerëzore, Zoti Mëshirëshumë u dhuroi atyre inteligjencë dhe aftësinë për të marrë përsipër përgjegjësi dhe të drejta. Kjo i shërbente përgatitjes së tyre për të përmbushur detyrat dhe të drejtat e përcaktuara nga Zoti. Aty Ai u fali njerëzve të drejtën e paprekshmërisë, lirisë dhe pasurisë që t'u bëjë të mundur të vazhdojnë jetën dhe të kryejnë detyrimet që kishin marrë mbi vete. Kësisoj, të drejtat për të marrë përsipër përgjegjësi dhe për të gëzuar liri dhe begati ekzistojnë në qenien njerëzore që kur lind. I papërgjegjshmi/fëmija dhe i përgjegjshmi/i rrituri janë të barabartë në këtë aspekt. Në këtë mënyrë i është falur njeriut individualiteti i duhur që në lindje, me qëllim që të vishet me të drejtat dhe detyrimet që në atë çast. Në këtë kuptim, i papërgjegjshmi/fëmija dhe i përgjegjshmi/i rrituri janë të barabartë.[3]

Ky respekt i lartë për dinjitetin e njeriut prodhoi në mjesjetë shoqëri ku komunitetet jomuslimane lulëzuan për shekuj me radhë. Natyrisht ekzistonte bindja se të drejta të caktuara u përkisnin më plotshëm atyre që kishin pranuar shpalljen e fundit të Zotit në Kuran. Ajo bindje nuk ishte aspak e çuditshme për atë kohë dhe njëmend mund të konsiderohet si normative në një kuptim të besimit tradicional. Sillni ndërmend, shumë më vonë, Papa Leon XIII, autor i enciklikes *Libertas*, një meditim i shkëlqyer teologjik mbi natyrën e dinjitetit njerëzor. Ky është mësimi i tij:

Prandaj e drejta e ndalon, arsyeja vetë e ndalon Shtetin të bëhet laik, apo të përvetësojë një vijë veprimi që do të shpiente në laicitet – përkatësisht, të trajtojë fetë e ndryshme (siç mund t'i quajmë) njësoj, dhe t'u japin atyre të drejta dhe privilegje shpresimisht të barabarta.[4]

Historikisht, muslimanët do të pajtoheshin me mësimin e tij. Ka që vazhdojnë të jenë të tillë edhe sot. Por ashtu siç duhet të ndryshojnë mesimet papnore, qoftë edhe në një moment kaq solemn, ashtu edhe muslimanët sot, për shkak të kësaj nevoje të shpejtë, duhet të pranojnë dështimin për të qenë më zemërgjerë karshi pjesëtarëve të minoriteteve religjioze. Por, më lejoni të hyj në një tokë më pak të njohur, muslimanët janë gjithashtu përpara thërritjes së të njëjtit mësim madhor të patjetërsueshmërisë së dinjitetit njerëzor për të shtyrë qeveritë të respektojnë të drejtat e muslimanëve gjithëpoaq. Në mjaft vende muslimane të drejtat e muslimanëve për të praktikuar fenë e tyre plotësisht, për të veshur rrobën e porositur nga tradita në hapësirat publike dhe educative, për të ndërtuar xhami dhe shkolla dhe për të folur lirishmi për reformimin e pushteteve që ata i konsiderojnë të korruptuar, janë të kufizuara. Sakaq muslimanët, ashtu siç bëjnë thirrje për rivendosjen kaq të nevojshme të idealit kuranor të dinjitetit dhe nderit të krijesës adamike në vendet ku ata përbëjnë shumicë, qëndrojnë në krah të muslimanëve që jetojnë në pjesë të ndryshme të Europës, ku lindja e një tribalizmi të ri pagan po e bën të patolerueshme jetën e muslimanëve religjiozë. Ne e njohim, dhe presim me respekt dhe mirënjohje, angazhimin e klerit dhe besimtarëve katolikë për të kapërcyer gjithë ato pengime që përfaqin

besimtarët muslimanë në Europë, më skajshëm në qytetet që kontrollohet nga formacionet politike të së djathtës ekstreme.

Jam kthyer, siç e shihni, në temën time të tragjedisë së Europës. Tashmë dëshmova besimin tim se, si mbështetës të Njerëzve të Librit, neve na pikëllon kriza shpirtërore e Europës dhe urojmë më të mirën për kishat në përpjekjen e tyre për ta shëruar atë. Risjell ndërmend shkrimin e katolikut të ndërgjegjshëm nga Belgjika, Jacques Neiryneck. Në romanin e tij *Rrethimi i Brukselit (Le siège de Bruxelles)* Neiryneck përshkruan një të ardhme të ankthshme në të cilin shovinizmi shkakton persekutimin dhe dëbimin e pakicës së urryer muslimane; por ai përfundon duke treguar se si zërat më përfaqësues të Islamit dhe Krishtëritit do të ngadhënjë përfundimisht. Besimi im personal është se bashkëpunimi dhe respekti i ndërsjellë do të ngadhënjë mbi barbarizmin pa dyshim.

Tani i kthehem një argumenti të brendshëm të muslimanëve. Duket se disa muslimanë besojnë se kjo bashkëjetesë, ndërveprim moral dhe mbështetje e ndërkahshme në çështjet e interesit shoqëror duhet të veçohen nga vëmendja ndaj teologjisë. Në disa raste mund të dëgjosh edhe mendimin se Krishtërimi, rrënjëzuar në besimin në mëkatshmerinë njerëzore, është mosbesues ndaj intelektit dhe se doktrinat e tij janë bazuar në një kapërcim të dukshëm të besimit. Pastaj kjo i vihet ndesh Islamit i cili, mëtojnë mendimtarë të tillë, është shqueshmërisht feja e arsyes dhe e një Zoti të arsyeshëm. Perceptime të tilla mund të gjenden në polemikat e Reshid Ridasë dhe shkollës së tij të rëndësishme. Ky zë vjen edhe nga mesi i muslimanëve më pak të kultivuar. Por nga çdo studim i doktrinës katolike është mjaft e kthjellët se arsyeja e natyrshme është e qendërsishme në ndërmarrjen intelektuale katolike. Sigurisht kjo nënkupton se dëshira jonë se bashkëpunimi ynë duhet të jetë pragmatike dhe jo thjesht parimore është keqduhur rëndë. Ka ardhur koha që muslimanët ta mirëpresin bashkëpunimin me katolikët mbështetur në bindjen se Katolicizmi, ashtu si Islami, flet gjuhën universale të arsyes.

Kur kjo të arrihet, do të ketë shumë për të bërë. Së bashku, muslimanët dhe të krishterët katolikë llogariten më shumë se dy miliard e gjysëm frymë: dukshëm më shumë se një e treta e popullsisë së planetit. Dokumenti "*Fjala e Përbashkët*" thekson, nga këndvështrimi i tij i Shkrimeve, nevojën jo vetëm për të pohuar parimet e përbashkëta të dashurisë për Zotin dhe për fqinj, por edhe për të shfaqur sinqeritetin e sipërmarrjes sonë në veprimin prijatar. Ç'është e vërteta, dy parimet janë bashkëfrymues.

Ne e dimë se kjo e jona është një epokë sfidash ndaj marrëdhënies sonë. Ka muslimanë, siç ka edhe të krishterë, që do të donin që ky kuvend i yni të mos mblidhej. *Fjala e Përbashkët* është kundërshtuar nga disa zëra muslimanë; disa të krishterë kanë shprehur mospuqjen me pergjigjet e ngrohta dhe pohimtare të të krishterëve, përgjigje që vijnë nga Jala, Lameth Palace dhe vatra të tjera të vetëdijes së krishterë. Në disa vende marrëdhënia jonë është duke njohur përmirësim; në disa të tjera ajo po vuan nga të meta kokëforta. Urdhëresa për dashuri ndaj Zotit dhe dashuri ndaj fqinjit, që në praktikë është një urdhëresë e vetme, jo gjithmonë është respektuar në veprat dhe zemrat tona. Tek të krishterët ekziston një drojë e mirëqenë ndaj ekstremizmit musliman. Gjithkëq tek muslimanët ekziston një drojë e pakundërshtueshme karshi thirrjes së Hans Küng, në librin e tij mbi Islamin, drejtuar politikës së jashtme imperialiste agresive të Amerikës,[5] që siç mendojnë një pjesë, drejtohet nga nacionalistë të krishterë, kur thotë se 'aktualisht mendësia e kryqëzatës po ringjallet'.[6] Si ne edhe ju duhet ta pranoni këtë drojë nga sho-shoqi.

Si muslimanë, duke qenë të urdhëruar për të qenë zemërçelur ndaj themeluesve të tre feve abrahamike, tensione të tilla na kanë shkaktuar dhimbje në mënyrë të përveçme. Nisma '*Fjala e Përbashkët*' është një shprehje e asaj dhimbjeje. Një mbrojtës i shkëlqyer i kësaj ka qenë Shkëlqesia e

Tij Kardilan Taurani në mesazhin e tij për fundin e Ramazanti publikuar gjashtë javë më parë. Ai e titullon letrën e tij: *Të krishterët dhe muslimanët: së bashku për dinjitetin e familjes*. Aty, kardinali lëvdon solidaritetin e përpamë mes muslimanëve dhe katolikëve në detyrën madhështore të mbrojtjes së këtij institucioni thelbësor të shoqërisë dhe bën thirrje për bashkëpunim të mëtëjshëm në të ardhmen.

Unë besoj se Shkëlqesia e Tij ka plotësisht të drejtë dhe se ai ka shenjuar një nga fushat më të rëndësishme në të cilat angazhimi ynë i përbashkët ndaj dinjitetit njerëzor mund të gjejë shprehje praktike. Si muslimanët ashtu edhe katolikët, nën përbuzjen e komentuesve shekullarë, përkrahin guximshëm imazhin e martesës si një kontekst i përsosur për shprehjen e seksualitetit njerëzor. Shenjtëria e Tij Papa Benedikti, në enciklikën e tij *Deus Caritas Est*, i ka kujtuar botës sërishmi dinjitetin dhe shenjtërinë e dëshirës seksuale të njeriut. Erotikja duhet të jetë pjesë e përshpirtshmërisë sonë dhe jo largim prej saj. Konteksti i duhur për këtë aspekt të veçantë të dinjitetit tonë si qenie të mishëruara është qartësisht jeta martesore. Në këtë aspekt muslimanët dhe katolikët do të donin të ndryshonin nga një tendencë e qartë reduksioniste në kulturën bashkëkohore, për të pranuar se burrat dhe gratë janë të ndryshëm në mënyra që kushtëzohen vetëm nga shoqëritë, më shumë se sa shprehje të ndryshme, por njësoj të vlefshme, të aspekteve të fuqisë së të Vetmit i Cili e ka krijuar njerëzimin në shëmbëllim të Hyjnore.

Le të huazojmë, në mënyrë analogjizuese, një ide nga teologjia trinitare e Hans Urs von Balthasar. Këtu, teologu gjenial zviceran na tërheq vëmendjen ndaj marrëdhënies mes personave të trinitetit. Ai shkruan: “Modalitetet hipostatike të qenies përbëjnë për njëra tjetrën kundërvënien më të madhe që mund të përfytyrojmë [...], pikërisht në mënyrë që ndërftoja më intime që mund të imagjinojmë të bëhet e mundur.[7] Dhe, duke hyjnizuar pikëpamjen e varfëruar moderne mbi gjininë, ai vazhdon dhe e identifikon marrë-dhënien e personave të Trinitetit në terma drejtpërsëdrejti gjinore: parimi mashkullor identifikohet me rolin fekondues, dinamik, ndërsa femërori me marrësin dhe lulëzuesin.[8] Një vleftësim i mënyrave klasike të të kuptuarit të krishterë të ndërsjellshmërisë së gjinive në jetën familjare është qartësisht i përafërt, në rrjedhimet e tija, me bindjet muslimane; ndonëse gjuha trinitariane për jetën e brendshme të Zotit është pamohueshmi larg nga besimi islam. Përfundime të përbashkëta për vlerën e ‘seksualiteteve alternative’ do vijojnë me siguri.

Një tjetër fushë ku ne tashmë kemi punuar bashkë me sukses të matshëm tregohet në përgjigjet e shkëlqyer dhe të hollësishme të Kryepeshkopit Rouan Uiliam ndaj *Fjalës së Përbashkët*. Ai vë gishtin në konfliktin Izraelito-Palestinez, si ‘çproblemi më kryesor apo një ndër më kryesorët e listës, që shqetësojnë si të krishterët ashtu edhe muslimanët në të gjithë botën’. Muslimanët janë të bindur se Selia Apostolike, e shqetësuar për komunitetet katolike dhe të tjera në Jerusalem, do të qëndrojë në krah të besimtarëve të krishterë dhe muslimanë të cilët, duke mos pranuar përgjigjet mizore dhe arbitrare terroriste, qëndrojnë guximshëm në të drejtën e tyre për dinjitet në truallin e tyre. Muslimanët janë jashtëzakonisht të prekur nga kurajo e shumë të krishterëve, si ish-Presidenti amerikan Xhimi Karter dhe Kryepeshkopi Desmond Tutu i Kejp Taunit, në dënimin e atyre që ata i quajnë politikatat Izraelite të aparteidit kundër komuniteteve muslimanë dhe të krishtera në territoret e pushtuara. Me të drejtë është thënë se përkrahja e dinjitetit të popullit palestinez është udha më e sigurtë drejt zemrave të muslimanëve dhe ne kemi besim se Vatikani do ta ketë parasysh këtë ndërsa përpiqet të mbrojë një zgjidhje paqësore si për hebrenjtë, muslimanët dhe të krishterët në Tokën e Shenjtë.

Por ka edhe pëllëmbë të tjera në tokën e Zotit ku dinjiteti njerëzor po shkilet. Nuk është mirë që muslimanët, përfshirë edhe muslimanët arabë, të kërkojnë vëmendje ndaj gjendjes së vështirë të

palestinezëve dhe të tregojnë më pak vëmendje ndaj viktimave të mizorive aktuale në Darfur. Ky skandal do shpjeguar dhe zgjidhur urgjentisht. Edhe më afër, tragjedia në Zaire në Lindore na thërret të gjithëve në një veprim të përbashkët. Duhet kujtuar marrëdhëniet e mira që u ruajtën në shumë raste në Ruandën fqinje, qoftë edhe në kulmin e atyre ngjarjeve tmerruese të fillimviteve '90.

Këto katastrofa që e shpërfitojnë tokën e Zotit janë thirrje për gjykim, janë gjyq. Ne nuk kemi qenë gjithmonë misionarët e paqes së Zotit. Pa dyshim është e parehatshme për ne të mësojmë se njeriu më i famshëm i paqes në shekullin e njëzetë, Gandhi, nuk qe as musliman, as i krishterë. Si një evropian, qytetar i një kontinenti që është krenar për trashëgiminë e tij monoteistike, unë vazhdoj të jem i helmuar nga kujtesa e luftërave të shekullit të shkuar, të cilat lanë pas në shkallë dhe në mizori luftërat e ndonjë kontinenti tjetër.

Ne thërritemi, është e qartë, të provojmë në sytë e botës se ne jemi forcë e të mirës. Kriza moderne e besimit nxitet tepër shpesh nga një ndjesi se feja prodhon frutin e hidhur të armiqësisë dhe madje konfliktit. Atëherë detyra jonë më e ngutshme, sakohë përpiqemi të rifitojmë rolin tonë si mbrojtës të dinjitetit njerëzor dhe respektit të ndërsjellë, është të shfaqim në praktikë dhe jo vetëm me fjalë se ne mund të punojmë bashkë për të mirën e përbashkët. Fatkeqësitë natyrore, kaq të pranishme në kohët tona ambjentalisht të trazuara, paraqesin një fushë të qartë për punë të përbashkët dhe është kënaqësi të shohësh progresin e bashkëpunimit ndërmjet CAFOD dhe Islamic Relief pas Memorandumit të Mirëkuptimit që u nënshkruan në 2003, në të cilin ata zotohen të mbështesin veprimtaritë e njëri-tjetrit në gjendje emergjence.[9] Islamic Relief dhe Christian Aid gjithashtu, në vendin tim, po dërgojnë ekipe të përbashkëta muslimane-kristiane në zonat e Afrikës jugore, në një skemë pilot që mban premtimin për bashkëpunim të mëtejshëm dhe më sistematik. Në ngjarjen e madhe Cut dhe Carbon Rally në Birmingham, më 21 gusht 2007, Christian Aid dhe disa organizata muslimane bamirësie forcën shëruese të një ngjarjeje publike që i thotë botës se vuajtjet mjedisore mund të shërohen nga bashkëveprimi ndërfetar, duke bashkuar energjitë dhe burimet për të ngërthyer një problem që është shumë i madh për agjensitë e një feje vetëm.

Uria globale që duket se po afrohet gjithnjë, e nxitur ndoshta nga rritja e konsumit të naftës, po krijon një konkurrencë vdekjeprurëse për burimet e kufizuara në shumë vende të Botës së Tretë. Raportohen gjithnjë e më shumë të vdekur nga uria dhe po ashtu po vuajnë edhe prodhuesit e vegjël. Në Indi shifrat tregojnë 166,000 fermerë të vetëvararë që nga 1997.[10] Urtësia jonë e përbashkët lidhur vetëm me shpërndarjen, dhimbsurinë për nevojtarin, e keqja e kamatës dhe një përpjekje politike në emër të të shtypurve pa diskutim duhet të vihet në veprim në një fushatë të përbashkuar në emër të babait tonë Abrahamit, përkarshi vuajtjeve të tilla.

Kjo duhet të jetë veçanërisht detyra dhe barra jonë. Si Islami ashtu edhe Katolicizmi janë në Europë. Por asnjëri nuk duhet të mëtojë një marrëdhënie të privilegjuar me këtë kontinent që të mos i zbresë të tjerët në një status dytësor. Të dy traditat tona kanë rrënjë substanciale në Azi dhe Afrikë. Në një kuptim, Azia është kontinenti i privilegjuar, kontinenti i shpirtit kur dihet që Qielli e ka bërë atë vendlindjen e të gjitha feve të mëdha. Sot, shumë pjesë të saj lulëzojnë por në pjesë të tjera dinjiteti njerëzor po vuan me trishtim. Sakaq në Afrikë, një kontinent i ndarë ngushtësisht ndërmjet Islamit dhe Krishtërit, gjithashtu thërritemi për të punuar së bashku për atë që na bashkon. Jezusi dhe Muhamedi nuk ishin vetëm mbrojtësit e të varfërve, por edhe jetuan mes tyre dhe sigurisht do të ringjallen me ta. Ky është një aspekt jetik i vëllazërisë së tyre dhe tonës. Në jetofshim ne në privilegj, duke i mveshur vetes krenimin e pavlerë të titujve dhe stolive tona, por duke dështuar për të punuar me duart dhe zemrat tona për ata, jetesa e të cilëve është në rrezik, atëherë ne do të kemi tradhëtuar

parimin abrahamik të dorëzimit vullnetit të Zotit, që do të thotë që ne të jemi gati të sakrifikojmë çka është e dashur për ne, pa asnjë ngurrim, me zemrën plot me hirin e Zotit.

Fjalët e Kuranit janë një thërritje dhe qortim për të gjithë ne:

Bismil-lâhîr Rrahmânîr Rrahîm

1. A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?
2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët
3. dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit.
4. Mjerë për ata, të cilët kur falen,
5. janë të pakujdesshëm për namazet,⁴²⁵
6. të cilët duan vetëm që të duken
7. dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve.

(Sure 107)

[1] Josef Van Ess, *The Flowering of Muslim Theology* (Cambridge MA: Harvard University Press, 2006), 153-4.

[2] Ernest Rénan, *De la part des peuples sémitiques dans l'histoire de la civilisation*, discours d'ouverture du cours de langue hébraïque, chaldaïque et syriaque au Collège de France (Paris: Michel Lévy, 1862), 27-8.

[3] Cituar në Recep Sentürk, 'Të Drejtat e Minoritetit në Islam: Nga Dhimmi në Qytetar', në Shireen T. Hunter dhe Huma Malik (eds.), *Islami dhe të Drejtat e Njeriut: Ngritja e një Dialogu SHBA-Muslimanë* (Washington DC: Qendra për Studime Nërkombëtare dhe Strategjike, 2005, 67-99, fq.74.

[4] Papa Leo XIII, *Libertas*, 21.

[5] Hans Küng, *Islami* (Oxford, 2007), fq.453.

[6] Küng, fq.311.

[7] Hans Urs von Balthasar, *Theo-drama II*, 258, cituar në Rowan Williams, 'Balthasari dhe Triniteti', 37-50 e Edward T. Oakes SJ dhe David Moss (eds), *The Cambridge Companion to Hans Urs von Balthasar* (Cambridge, 2004), see p. 41.

[8] *Teo-drama V*, cituar në Rowan Williams, 'Balthasar dhe Triniteti', 45.

[9] www.cafod.org.uk/partnership/other-faiths

[10] Randeep Ramesh, *The Guardian*, 1 March 2008.

Date Created

16/10/2014

Author
erasmusi